



Gjuha dhe integrimi

Integrimi

Ofertat për integrim

Gjuha

Të mësosh gjermanisht

Integrimi

Kur jetoni në kantonin Basel-Stadt, keni të drejta të caktuara. Nuk ka rëndësi, a jeni burrë apo grua, nga vini, ç' gjuhë flisni, ç' besim keni ose ç' aftësi të kufizuara. Njëkohësisht duhet t'i zbatoni ligjet. Gjithashtu ka rëndësi, që ju të kujdeseni për veten nga ana ekonomike dhe që të mësoni gjermanisht. Këtu gjendeni informacione për këtë temë.

Parimet themelore më të rëndësishme

Kur jetoni në Zvicër, ju duhet t'i përmbaheni kushtetutës së konfederatës dhe ligjeve. Kjo do të thotë për shembull: Të gjithë njerëzit janë të respektueshme me njëri-tjetrin. Të gjithë njerëzit trajtohen njëllë, askush nuk diskriminohet. Nëse jetoni në Basel, ju duhet të mësoni gjermanisht. Veç kësaj, ju duhet përkujdeseni për vetën në anën financiare.

Mirëpo integrimi funksionon vetëm, nëse të gjithë japin kontributin. Banoret dhe banorët e Bazelit duhet të jenë të hapur kundrejt jush. Ata duhet t'ju informojnë dhe duhet t'ju përkrahin.

Përgjegjësia individuale

Ju keni ardhur tani me shtëpi në Basel? Konfederata, kantonet dhe komunat kujdesen, që ju merrni një qasje të drejtë për jetën ekonomike, sociale dhe kulturore. Por ju duhet të kujdeseni edhe vetë, që ju të integrohëni. Ne presim nga ju, që ju i shfrytëzoni ofertat e integrimit.

Pjesëmarrja në jetën shoqërore

Kështu mund të integrohëni: Nëpër shoqatat mund të njiheni shumë mirë me njerëz të rinj. Ose ju shkoni në festa dhe organizime të lagjes suaj.

Ndoshta në fillim kjo duket pak e vështirë. Disa persona nuk janë të hapur kundrejt njerëzve prej vendeve të huaja. Por pas një farë kohe shumica e njerëzve humbet rezervimin e vet. Pra mos u dorëzoni.

Njoftime / mbështetje

Ju keni ardhur tani me shtëpi në Basel dhe keni nevojë për ndihmë dhe informacione? Në Basel-Stadt ka zyra të ndryshme, të cilave mund t'u drejtoheni. Tek zyrat e kantonit Basel-Stadt dhe të komunës suaj të banimit merrni informacione. Por ka gjithashtu edhe pika kontaktimi posaçërisht për migrantet dhe migrantët. Informacione për jetën në Zvicër dhe për tema të tjera:

- GGG Migration

Informacione për të drejtën e azilit dhe për të drejtën e të huajve:

- Beratungsstelle für Asylsuchende BAS
- Freiplatzaktion

Ju nuk flisni ende gjermanisht? Atëherë mund të sillni dike, që përkthen për ju. Apo ju mund të kërkoni një përkthyes apo përkthyes.

Më shumë informacione (link, adresa, broshura, fletushka)

www.hallo-baselstadt.ch/sq/gjuha-dhe-integrimi/integrimi

Ofertat për integrim

Në shkollë, shkollim profesional dhe punë mund të integrohemi më së miri. Por ndoshta ende nuk keni një punë ose shkollim profesional. Dhe edhe nuk shkoni në shkollë. Atëherë mund të shfrytëzoni oferta të ndryshme për integrim.

Ofertat specifike

Ka shumë oferta posaçërisht për këta njerëz, që sapo janë shpërngulur në Basel. Për shembull biseda në grup, oferta për kohën e lirë, ligjëratat ose kurse. Ofertat ju ndihmojnë, që të ambientoheni dhe të njiheni me njerëz të tjerë. Zyra e konsultimit "GGG Migration" ju informon, se çfarë ofertash ekzistojnë.

Kantoni dhe lagjet organizojnë ngjarje për të mirëpritur banoret e reja dhe banorët e rinj. Këtu gjeni informacione të rëndësishme për të marrë një përshtypje të parë.

Shoqatat

Shumë zvicerane dhe zviceranë janë anëtarë në një shoqatë (Verein). Ka shoqata për interesa më të ndryshme, për shembull shoqata sporti ose kulture. Nëse anëtarësoheni në një shoqatë, ju mund të njiheni me njerëz të tjerë. Shumica e shoqatave është e hapur për të gjithë personat.

Organizatet e Migrimit (DE)

Ka edhe shoqata të migrantëve dhe migrantëve. Anëtarët e shoqatave shpesh flasin të njëjtën gjuhë, vijnë nga i njëjti vend ose kanë të njëjtën fe. Këto shoqata shpesh kanë oferta për njerëz, që vijnë për herë të parë në Zvicër dhe në kanton Basel-Stadt. Ata mund të ju përkrahin gjatë integrimit.

Ofertat për të rinj

Të rinjtë mund të shfrytëzojnë në kohën e tyre të lirë shumë oferta, ku ata mund të njihen me bashkëmoshatarët. Ata mund të marrin pjesë në një projekt dhe mund të hedhin idetë e veta. Ka specialistë, që kujdesen për të rinjtë dhe që i shoqërojnë (Jugendarbeit). Zakonisht ofertat janë falas.

Pika takimi nëpër lagje

Pika takimi nëpër lagje (Quartiertreffpunkte) janë të hapura për të gjithë njerëzit. Ata kanë oferta për familjet, të moshuarit dhe për personat, që akoma flasin vetëm pak gjermanisht. Disa pika takimi janë qendra familjesh. Këtu ka takime të hapura për nëna dhe baballarë me fëmijët e tyre. Pikat e takimit nëpër lagje ju këshillojnë dhe përkrahin në jetën e përditshme. Në pikën e takimit nëpër lagje, ju mund të merrni ambiente me qira për festa familjare dhe ngjarje të tjera.

Më shumë informacione (link, adresa, broshura, fletushka)

www.hallo-baselstadt.ch/sq/gjuha-dhe-integrimi/ofertat-per-integrim

Gjuha

Ju keni ardhur me shtëpi në Basel-Stadt dhe ende nuk e flisni gjuhën gjermane? Atëherë bëni mirë të mësoni sa më parë gjermanisht. Kur flisni gjuhën, ju njiheni më mirë me vendin dhe njerëzit. Dhe gjeni më lehtë punë.

Gjuha standarde gjermane / gjermanishtja zvicerane

Zvicra ka katër gjuhë vendore: gjermanisht, frëngjisht, italisht dhe retroromanisht. Në kantonin Basel-Stadt gjuha gjermane është gjuha zyrtare. Ka gjuhën letrare gjermane (Hochdeutsch) dhe gjermanishten zvicerane (Schweizerdeutsch).

- Gjermanishtja standarde (Standarddeutsch)
Njerëzit në pjesën gjermane të Zvicrës shkruajnë në gjermanishten standarde. Dhe ata flasin gjermanishten standarde në shkollë dhe pjesërisht ë radio dhe në televizor.
- Gjermanishtja zvicerane (Schweizerdeutsch)
Gjermanishtja zvicerane është një dialekt i gjuhës gjermane. Njerëzit flasin në jetën e përditshme më shumë gjermanishten zvicerane. Ndoshta gjermanishten zvicerane e keni të vështirë të kuptoni, edhe kur tashme flisni mirë gjermanisht. Ju nuk kuptoni diçka? Atëherë mund të lutni njerëzit me gjithë dëshirë, që ata të flasin gjermanishten standarde me ju. Nuk është nevoja që ju vetë të flisni gjermanishten zvicerane. Por është e rëndësishme që ta kuptoni pas një farë kohe.

Gjermanishtja dhe fëmijët

Fëmija juaj flet një gjuhë tjetër në vend të gjermanishtes? Atëherë ai duhet të njihet sa më parë me fëmijët, që flasin gjermanisht. Kështu fëmija juaj mëson më shpejt. Ai mund të shkojë për shembull në një grup për lojë. Ka edhe oferta speciale për prindër dhe fëmijë.

Fëmija juaj ende nuk flet gjermanisht ose e flet vetëm pak? Atëherë fëmija juaj duhet të mësojë gjermanisht të paktën një vit para hyrjes në kopsht. Ne ju informojmë me një letër 18 muaj para hyrjes në kopsht. Ka për shembull këto oferta:

- Grup për lojë me mësim gjermanishteje
- Kujdestaria ditore për fëmijë (Kita), ku flitet gjermanisht
- Familje ditore

Edhe ju mund të përkrahni fëmijën tuaj në zhvillimin e tij gjuhësor. Flisni shumë me fëmijën tuaj, dëgjoni, kur fëmija juaj flet, dhe tregoni histori. Flisni në atë gjuhë, të cilën zotoni më mirë dhe që e preferoni.

Përkthimet me shkrim / shërbimet e përkthimeve me gojë

Ju sapo keni ardhur me shtëpi në Basel dhe ende nuk flisni mirë gjermanisht? Atëherë nganjëherë ju duhet një person, që përkthen për ju. Ndoshta mund të pyesni të afërmit ose persona të njohur.

Mirëpo ka situata, në të cilat janë të vështira ose shumë personale. Për shembull një takim në spital ose në një zyrë. Atëherë ju dëshironi më mirë një përkthyes ndërkulturore ose një përkthyes ndëkulturore. Këta janë specialistë posaçërisht për njerëz, që vijnë nga një kulturë tjetër. Specialistet njohin kulturën tuaj dhe mund të përkthejnë në këtë mënyrë, që ju kuptoni gjithçka.

Ju merrni letra nga zyra shtetërore dhe nuk e kuptoni? Ose duhet të plotësoni një formular ose të shkruani një letër? Këtu gjeni ndihmë:

- Shërbimi i përkthimit nga GGG Migration

Nivelet e gjuhës në të drejtën e të huajve dhe në të drejtën civile

Ndoshta doni të aplikoni për leje qëndrimi (B) ose leje vendbanimi (C). Ose dëshironi marrjen e nënshtetësisë. Gjermanishtja nuk është gjuha juaj e parë? Atëherë ju duhet një vërtetim, që flisni mirë gjermanisht.

Këtu merrni informacione, se çfarë ju duhet për aplikimin:

- Zyra e migracionit (Migrationsamt)

Më shumë informacione (link, adresa, broshura, fletushka)

www.hallo-baselstadt.ch/sq/gjuha-dhe-integrimi/gjuha

Të mësosh gjermanisht

Në një kurs gjermanishte ju mund të mësoni mirë gjermanisht. Ka kurse të ndryshme për gjuhën gjermane.

Ofertat

Ka kurse të ndryshme gjermanishte. Për shembull:

- Kur keni fëmijë të vegjël, ju ndiqni një kurs me kujdestari fëmijësh.
- Ndoshta akoma nuk i njihni shkronjat latine ose keni probleme me leximin dhe shkrimin. Atëherë ju ndiqni një kurs alfabetizimi (Alphabetisierungskurs).

Këtu mund të informoheni, se ç' kurse ekzistojnë dhe sa kushtojnë kurset:

- Zyra e specializuar e arsimit të të rriturve (Fachstelle Erwachsenenbildung)
- GGG Migration

Nivelet gjuhësore

Në ç' nivel një njeri flet gjermanisht, kjo mund të matet me "Kornizën e përbashkët evropiane të referencës". Shkurtimi për te është GER. GER është një matës për gjuhën dhe ka 6 nivele: A1, A2, B1, B2, C1 und C2. Kur keni arritur nivelin A1 ose A2, keni njohuri bazë në gjermanisht. Kur arrini nivelin C1 ose C2, ju keni përparuar shumë.

- Ju dëshironi të bëni një formim profesional, që njihet në Zvicër? Atëherë ju duhet niveli B1 ose B2.
- Kur dëshironi të studioni në një universitet, ju duhet niveli C1 ose C2.

Financimi

Ju keni ardhur tani me shtëpi në Basel dhe merrni një leje qëndrimi B? Atëherë merrni një kupon për një kurs gjermanishte. Ju mund të ndiqni 80 leksione falas. Ju mund ta këmbëni kuponin në një shkollë gjuhësore, e cila është e licencuar nga kantoni. Kuponi vlen për 12 muaj pas hyrjes suaj.

Ju dëshironi të bëni një kurs gjermanishte më vonë? Atëherë duhet të paguani për të. Kurset kanë çmime të ndryshme. Ia vlen t'i krahasoni ofertat. Kantoni Basel-Stadt mbështet disa kurse me një shumë financiare. Për këta kurse paguani më pak.

Më shumë informacione (link, adresa, broshura, fletushka)

www.hallo-baselstadt.ch/sq/gjuha-dhe-integrimi/me-mesue-gjermanisht